



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë më

Nr.

prot.

Data: 24.2.2025

Nr: 149

Ora: 14:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË PARTISË POLITIKE “PARTIA BASHKIMI
DEMOKRAT SHQIPTAR”, ME KRYETAR Z. YLBER VALTERI, PËR
REGJISTRIMIN SI SUBJEKT ZGJEDHOR PËR ZGJEDHJET PËR KUVEND, TË
DATËS 11 MAJ 2025**

Sot, më datë 24.2.2025, në seancë publike, mora në shqyrtim kërkesën me nr. 1155 prot., datë 20.2.2025, me:

KËRKUES: Partia politike “Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar”, me kryetar Z. Ylber Valteri

OBJEKTI: Regjistrimi i partisë politike “Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar” si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 Maj 2025

BAZA LIGJORE: Neni 64, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ,

V Ë R E J:

Presidenti i Republikës, me Dekretin nr. 399, datë 5.12.2024, ka caktuar datën 11 Maj 2025 për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë.

Data: 24.2.2025 Nr: 149
Ora: 14:00



“Për shqyrtimin e kërkesës së partisë politike “Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar”, me Kryetar Z. Ylber Valteri, për regjistrimin si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 Maj 2025”

“Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar” nëpërmjet Kryetarit, z. Ylber Valteri, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvend, që do të zhvillohen më datë 11 Maj 2025.

Bashkëlidhur kërkesës është paraqitur dokumentacioni vijues:

- a) Vërtetimi i lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Partive Politike pranë Gjykatës së shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Tiranë, datë 11.2.2025, nëpërmjet të cilit vërtetohet se “Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar”, me initiale “PBD”, me Kryetar z. Ylber Valteri, rezulton e regjistruar në dokumentacionin e kësaj Zyre.
- b) Deklarata e angazhimit solemn (Model KQZ-04-02);
- c) Deklarata për hapjen e llogarisë së posaçme bankare të partisë politike (Model KQZ-04-03).

Nga dokumentacioni si më sipër, si dhe nga përmbajtja e kërkesës rezulton se:

- a) Emri zyrtar i partisë është “Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar” me shkronja nistore “PBD”, me adresë” Rruga "Mine Peza", Vila nr.4, Tiranë;
- b) Kryetari i partisë është z. Ylber Valteri, me adresë: Rruga "Vace Zela", nr. 48, Tiranë;
- c) Financieri i partisë është zj. Irena Valteri, me adresë: Rruga "Vace Zela", nr. 48, Tiranë;
- ç) Personi përgjegjës për komunikim me KQZ-në, është z. Ylli Subashi, me adresë: Rruga "Ferit Xhajko", Pranë Ish Restorant Durrësit, Tiranë;
- d) Specimeni i vulës së partisë është i specifikuar.

Kërkesa e paraqitur nga “Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar”, respekton afatin kohor të parashikuar në pikën 1, të nenit 64, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Dokumentacioni bashkëshoqërues i kërkesës, i paraqitur nga “Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar”, është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenet 64, pika 2 dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1 shkronja “n”, e 2, 64, dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, si dhe të Udhëzimit nr. 2, datë 22.1.2025, “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 11 Maj 2025”,

V E N D O S :

1. Regjistrimin e partisë politike “Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar”, me kryetar z. Ylber Valteri, me shkronjat nistore “PBD”, si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 Maj 2025.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI